Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Florije Rexhepi	**20.10.2023**	**02.11.2023**	**2023/0793**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 13.10.2023, OE "V- SH " Loti " SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0793, , kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE Eurokod- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Zhvarrosja,transporti,arkivoli,vorrosja,vendosja e gureve me mbishkrime" me nr. të prokurimit: "KEK-23-3646-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë te hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 63,000.00€.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë: 18.04.2023; data e njoftimit për informata shtese ose përmirësim i gabimit 18.04.2023; data e hapjes së ofertës: 02.05.2023 , data e njoftimit mbi vendimit e AK-se: 29.09.2023.

Ankesa është e përsëritur: Vendimi i Panelit Shqyrtues OSHP: 2023/0316. 2023/513 dhe 2023/501.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 24 Zyrtarët e Prokurimit gjatë Ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit

Neni 27 Dosja e Tenderit

Neni 28 Specifikimet teknike

Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës

Neni 54 Njoftimi i Kandidateve dhe Tenderuesve te Eliminuar

Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Neni 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë	**1. Operatori ekonomik duhet te përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04 L-042 Neni 65. 2. Një vërtetim i nënshkruar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.- kërkohet vetëm për fituesin e tenderit. 3. Një dokument lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e pershtatshmerise" Pika III.1.1.) 2.a,c,d dhe e. – kopje e noterizuar .- kërkohet vetëm për fituesin e tenderit., 1. Një deklarata nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit. Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërise, pika 2, dhe 3 do të kërkohen nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit te këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet.**
Përshtatshmëria profesionale	**1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit; 2. Regjistrimi i TVSH; ne vendin e themelimit 3. Regjistrimi i numrit fiskal, 1. Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin**
	evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend Kopja e certifikatës së biznesit) 2. Kopja e certificates TVSH-se 3. Kopja e certificates numrit fiscal

Kapaciteti teknik dhe profesional	**1.Projektet e realizuara brenda 5 viteve të fundit 2.Posedimi i paisjeve, 1.Një liste te aktiviteteve të ngjashme të OE qe specifikon punët e kryera si dhe OE duhet të prezantoje certifikata mbi përfundimin e punëve nga punëdhënësi mbi implementimin e suksesshëm të projekteve për pese vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë me kontaktet për verifikim, me një fushëveprim të ngjashëm të punëve nga ku mund të shihet kapaciteti teknik dhe përvoja e tij 2.Operatori ekonomik duhet te dështoj se posedon pajisje për realizimin e shërbimit minimum një eksavator ,minimum një automjet te pershtashme per bartjen e kufomave, vegla pune per zhvarrosje varrosje si p.sh hillt, gjenerator,kazma etj**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

OE ankues eshte i papërgjegjshëm

OE i rekomanduar për kontrate eshte i pergjegjshem.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Vendimi i Panelit Shqyrtues OSHP: 2023/0316. 2023/513 dhe 2023/501.

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **V- SH " Loti " SH.P.K.**

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i pakënaqur me vendimin e AK-se, konform nenit 108/A ka parashtruar ankese ne OSHP, me pretendimin se autoriteti kontaktues – Korporata energjetike e Kosovës, nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-se, kryesisht nenin 59 të LPP-se, me këtë rast ka rekomanduar për kontrate një operatore ekonomik i cili nuk i plotëson kriteret e dosjes se tenderit.

Autoriteti Kontaktues – Korporata Energjetike e Kosovës, me datën 29.09.2023 ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-se.

Pretendimi nr.1

OE ankues pretendon se AK – KEK SH.A, me datën 18.04.2023, ka publikuar njoftimin për informata shtese ose përmirësimin e gabimit ka lejuar përmes kërkesave te kapacitetit teknik dhe profesional qe operatoret ekonomik te prezantojnë dëshmi për realizim te projekteve te ngjashme për periudhën kohore prej 5 viteve, nder tjera OE ankues pretendon se bazuar ne kërkesat e kualifikimit dhe gjendjes faktike përkatësisht ofertës se OE te rekomanduar për dhënie te kontratës, AK – KEK ka shkelur dispozitat e nenit 69 paragrafi 4 ku potencohet se për procedura te prokurimit qe kane te bëjnë me sigurim te shërbimeve AK mund te kërkojë nga OE-te qe te sigurojnë te dhënat me te cilat dëshmohet aftësia e tyre profesionale për sigurimin e këtyre shërbimeve.

Eksperti shqyrtues, sqaron se Autoriteti kontraktues ne kërkesën e dosjes se tenderit te Kapaciteti teknik dhe profesional ka kërkuar:

1.Projektet e realizuara brenda 5 viteve të fundit, 1.Një liste te aktiviteteve të ngjashme të OE qe specifikon punët e kryera si dhe OE duhet të prezantoje certifikata mbi përfundimin e punëve nga punëdhënësi mbi implementimin e suksesshëm të projekteve për pese vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë me kontaktet për verifikim, me një fushëveprim të ngjashëm të punëve nga ku mund të shihet kapaciteti teknik dhe përvoja e tij.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues pretendon se i rekomanduari për kontrate, e ka dorëzuar një kontrate me titull: Dislokimi I varrezave nga traseja e autorruges R6, segmenti C2 dhe C3, me nr. te prokurimit: MI/16/071/221, te iniciuar nga Ministria e infrastrukturës, e cila sipas OE ankues nuk është valide me arsyetimin se Gjykata kompetente ka nxjerr një aktgjykim ku kontrata është shpallur e kundërligjshme.

Eksperti shqyrtues pasi ka analizuar pretendimin e OE ankues dhe provat e dorëzuara nga OE ankues lidhur me ketë pretendim, ka vendosur dhe njeherit ka kërkuar sqarim nga autoriteti kontraktues lidhur me realizimin e këtij projekti.

Korrespodencat me AK-MI:

Te nderuar

Ne cilësinë e ekspertit te prokurimit, jam autorizuar për te shqyrtuar pretendimet ankmiore te një Operatori ekonomik, I cili pretendon se OE Euro Kod ka dorëzuar një kontrate dhe reference te pavlefshme.

Kontrata ne fjale është e nënshkruar me juve si autoritet kontraktues dhe mban titullin: **Dislokimi I varrezave nga traseja e autorruges R6, segmenti C2 dhe C3**, me nr. te prokurimit: **MI/16/071/221** dhe për te njëjtën OE Euro kod, ka dorëzuar edhe raportin e pranimit te punëve, mirëpo ne ankesën e OE ankues deklaron se ka një aktgjykim nga gjykata kompetente me te cilin kontrata është vlerësuar si e kundërligjshme.

Andaj, kërkojmë nga ju te me informoni se:

1. A është realizuar kontrata për ketë aktivitet te prokurimit ne tërësi dhe
2. A është valid raportin I pranimit Teknik te punëve

Bashkangjitur ne attach e gjeni kontratën dhe raportin.

Përgjigja e AK-se:

E nderuar,

Kontrata ,,**Dislokimi i varrezave nga traseja e autorruges R6, segmenti C2 dhe C3**, me nr te prokurimit: **MI/16/071/221** eshte realizuar, pranimi teknik eshte valid, ndersa ne adres te MMPHI kemi pranuar aktgjykim lirues.

Ne attachment keni te bashkangjitur Aktgjykimin lirues.

LIROHET NGA AKUZA

Sepse:

II. I pandehuri Hajredin Hajra, në cilësinë e Drejtorit të Biznesit "Eurokod" SH.P.K, me qëllim të pranimit të ofertës nga autoriteti kontraktues për aktivitetin e prokurimit me titull të kontratës "Dislokimi i varrezave nga traseja e Autostradës R6, segmenti C 2 dhe C 3", me numër të Prokurimit MI/16/071/221, me datë 17.06.2016 në Prishtinë, në kundërshtim me kriteret e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë kishte dorëzuar ofertën në bazë të një marrëveshje të kundërligjshme, ku marrëveshja për themelimin e grupit të operatorëve ekonomik "Eurokod", SH.P.K. dhe "Engenieering Group" SH.P.K. ishte bërë që të plotësohen kriteret formale, më saktë të përdorej referenca e "Engenieering Group", kurse në zbatim të kontratës ishte përjashtuar operatori ekonomik "Engenieering Group" nga i pandehuri, me ç` rast nuk e kishte lejuar të marrë pjesë në implementim të kontratës me numër MI/16/071/221, të datës 20.07.2016, me qëllim që vetes ti sjell dobi pasurore.

- me këtë kishte për të kryer veprën penale Marrëveshjet për kufizimin e konkurrencës përmes ftesave për tender, nga neni 309 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Pretendimi OE ankues për kontratën e përmendur me larte, nuk qëndron edhe per faktin se AK-ja, është deklaruar se OE EuroKod e ka përfunduar projektin ne fjale dhe se kontrata dhe pranimi teknik janë valide.

Lidhur me kete çështje OE ankues ka një pretendim ku deklaron se AK-ja e ka favorizuar OE te rekomanduar për kontrate me arsyetimin se AK-ja, ne dosje te tenderit ka kërkuar kontrata ne 5 vitet e fundit. Eksperti shqyrtues konform nenit 108/A, sqaron se OE ankues lidhur me ketë pretendim është dashur te parashtrojë ankese ne fazën e njoftimit për kontrate, pra para dorëzimit te ofertave.

Pretendimi nr.2

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për dhënie te kontratës nuk posedon kod veprimtarie dhe si operator ekonomik nuk ka kurrfarë përvojë eksperience lidhur me natyrën e kësaj procedure të prokurimit.

Eksperti shqyrtues, sqaron se pretendimi i OE ankues, se i rekomanduari nuk posedon kod veprimtarie, nuk qëndron për faktin se ne dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontrate nuk është kërkesë e dosjes se tenderit dhe pretendimi për ta eliminuar për një kërkesë e cila nuk është e vendosur ne dosje te tenderit dhe ne njoftimin për kontrate do te ishte ne kundërshtim me paragrafin 3 te nenit 56 te LPP-se.

Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave të negociuara, pas publikimit të njoftimit të kontratës, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohen nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në

njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Pretendimi nr. 3.

OE ankues pretendon se AK – KEK Sh.A fare nuk nxjerre letër standarde dhe nuk jep arsye te eliminimit për operatoret ekonomik pjesëmarrës ne ketë procedure te prokurimit përfshirë edhe ofertën tone.

Me datën: 26.10.2023, eksperti shqyrtues, i është drejtuar me shkrim autoritetit kontraktues, për te sqaruar faktin se a e është njoftuar OE ankues me letër standarde.

Ne përgjigje përfaqësuesi i AK-se, ka deklaruar se:

Fillimisht ju njoftoj se OE V- SH " Loti " SH.P.K. është shpall i pa suksesshëm, e jo i eliminuar pasi qe ka qene me çmim me i lart sesa OE i rekomanduar për kontrate Eurokod.

Ndërsa sa i përket pretendimit te tij se nuk ka qene i njoftuar është pretendim i pa sakt, pasi qe ka qene i njoftuar me letër standarde si i pa suksesshëm. Te bashkangjitur gjeni deshmit te cilat janë marre nga E prokurimi ku dëshmohet se OE V-SH Loti ka qene i njoftuar me datën 29.09.2023 ne ora 14:27.

37	MINATOR FERIZI	Dorëzimi dokument B46 Leter standarde per tenderuesin e pasuksesshem OE - V- SH " Loti " SH.P.K., numri fiskal -	07.07.2023 14:3

KEK

Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm [1]

Korporata Energjetike e Kosovës sh.a.
Rr. Nëna Terezë nr. 36, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

V-SH Loti
Kosovë, Prishtinë

Nr[2] i prokurimit	**KEK-23-3646-2-2-1**
Nr i brendshëm	**KEKC-23-012-221**

Titulli: Zhvarrosja,transporti,arkivoli,vorrosja,vendosja e gureve me mbishkrime

I/e nderuar(a)

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042,i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092,siç citohet në vazhdim "LPP ".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kritereve të dhëna në Njoftimin për Kontratë dhe ne Dosjen e Tenderit.
Me keqardhje ju njoftojmë se tenderi i paraqitur nga ana juaj nuk qe i suksesshëm, ngase tenderi juaj nuk qe tenderi me çmimin më të ulët në mesin e tenderëve që plotësonin kërkesat e dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Ju informojmë se pas rivlerësimit te ofertave si dhe pas sqarimeve te bëra konform vendimit te OSHP-se kontrata i është dhënë Operatorit Ekonomik **EUROKOD SH.P.K** për një shumë prej **53,265.20 €** (me TVSH).

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimin e intervalit, gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.
Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit .

Me respekt,
Zyra Ekzekutive e Prokurimit
KEK – sh.a.

27/09/2023

Eksperti shqyrtues, pasi ka analizuar te gjitha shkresat e lendes, sqaron se ky pretendim i OE nuk qëndron për faktin se AK-ja KEK SH.A, me datën 29.09.2023 ka njoftuar OE ankues me letër standarde si i pa suksesshëm sipas nenin 54 të LPP-se.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **V- SH " Loti " SH.P.K.**

Florije Rexhepi